

AISHE ALIÇKAJ

PËR TY

LIRIKA

BOTIMET TOENA

AISHE ALIÇKAJ

PËR TY

lirika

BOTIMET TOENA

Tiranë

Botuese: Irena Toçi

Kryeredaktore: Edona Marku Huqi

Redaktor: Shuaip Duka

Përkujdesja grafike dhe kopertina: Elsa Hajderaj

ISBN 9789928376992

© Autorja

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Nuk lejohet shumëfishimi me asnjë lloj mjeti apo forme, as me fotokopje, pa lejen me shkrim të mbajtësit të copyright-it.

BOTIMET TOENA

Rr. "M. Gjollësja", K. Postare 1420, Tiranë

Tel.: + 355 4 22 40 116

Email: botimet.toena@gmail.com

toena.porosionline@gmail.com

<https://toena.al>

FRYJ MOJ ERË

Fryj moj erë e merrmë mua
Të më çosh atje ku dua,
Mbi balluke të bandillit
Si fletët e trëndafilut.

Palë, palë, derdhur mbi ballë,
Varur poshtë përmbi qepallë,
Aty era më lëshoftë
Nga andrallat më shëroftë.

Aty të shtrihem të fle,
Në gjumë t'më vërë ai zë.
Pa le të mos ngihem më.

Fryj moj erë e mos ki derte,
Fryj e merrmë me vete,
Më fshih në kopsht të bandillit,
Ku ka shtratin trëndafilu.

Të vërë kokën përmbi mua,
Që ta puth sa herë të dua.

Në fjetsha më lër të fle,
Mbulomë, në s'u ngrita më,
Në vdeksha, më lër të vdes,
Mbase ngjallem në mëngjes.

E të bëhem pendë e lehtë,
Të fluturoj si shpend,
Bashkë me ty në ato hije
Përmbi re, përmbi korie.

Balluket derdhur mbi ballë,
Me buzë t'i shëtis me radhë,
Të ndalem pak te sytë
Me buzë të t'i ngre qerpikët,

Ta puth dhe gushën që pret,
Të mbytem në atë det.

GONXHE MBULUAR ME VESË

Gonxhe mbuluar me vesë
Gjoksin ngritur edhe ftisur,
Kur më shkon serbes, serbes,
Syrit ç' i rëndon qerpiku.

Kur më shkon si shtojzovalle,
Derdhur trupi porsi ngjalë,
Syri i zi ndriçon dynjanë
I thotë hënës të mos dalë.

Moj valëza, vello mëndafsh
Që baret si balerinë,
Nдалu pak, ec më avash
Lëre bregun ta puthë synë.

Të të puthë sy e gushë
Lëre të të hapë gjinë,
Të të marrë erërat që vijnë
Borzilok e trëndelinë.

FUSTANI

Fustani me lule shumë
Të përdridhet përmbi gjunjë,
Shkurtoje pak më shumë,
Të ta puth atë lëkurë.

Lëkura porsi mëndafshi
I shkreti, zemra më plasi,
Porsi e lyer nga gjalpi,
Lërma dorën të rrëshqasë.

Të rrëshqasë, të rrëshqasë,
Që dhe zemra të mos plasë,
Lart e lart e sa më lart,
Ku shpirti bie rehat.

More fustani mëndafsh
Më ndeze, më vure flakë
Fryj moj erë e ngrije lart,
Mbase freskohem ndopak.

KUR TI MË PUTH NË BUZË

Kur ti më puth në buzë,
Ato nuk më njomin si më parë.
Më tmerron tharja e tyre si shkarpë,
Edhe pse ti vazhdon e i puth prapë.

Ato dy buzë më parë
Më ëmbëlsonin, drithëronin, eksitonin,
Në çdo skutë e qelizë e vend.
Tani më hidhërojnë,
Janë të thara e krejt pa lëng.

Ato dy buzë dikur
Bashkonin fuqishëm zemrat tona.
Tani më vrasin, bezdisin deri në neveri.
Ç'ka ndodhur me ty o njeri?

Mos vallë mbi to ke mbjellë zhavorr
E ruli i pabesisë i shtyp si mizor?

DASHURI

Të pres në çdo hap,
Të kërkoj afër dhe larg
Dashuri.

Në shi dhe në vapë,
Ditë dhe natë
Dashuri.

Dikush të kap me grep,
Dikush të kap me lak,
Dashuri.

Dora e ngrohtë e zemrës
Baret të të kapë,
Dashuri.

Në zhgënjimin e kësaj bote
S'të kemi të gjithë për fat,
Dashuri.

SORKADHJA LART NË ÇIKË

Sorkadhja lart në Çikë,
Baret pyllit porsi bleta.
Sorkadhe ç'më shkel në thua
Nëpër borë e në livadhe,
Do t'i gjej gjurmët e tua
Moj xhindja në radhua.

Sorkadhja lart në Çikë
Qafa e gjatë prek kaltërsitë,
Ylberi i syrit të ndrit,
Shëtiti natën bashkë me yje,
Në çdo hap ma bën me hile.

Me pisha e me thëllëza
Lot e qesh bën shoqërinë,
Ditën rritesh e stolisesh
Natën fle me perëndinë.
Të lutem, të përgjërohem
Ktheji sytë për djalërinë.

ISHA DASHURUAR

Dera rrëshqiti
Dhe u futa brenda,
S'kuptova ç'më ndodhi,
Në shpirt e te zemra
Një vullkan me llavë
Më dogji përbrenda.
Gjunjët m'u lëkundën
Si varka mbi valë,
Fryma përpëlitej
Për një çast u shua,
Ç'kishte ndodhur vallë?
Kush po më tremb mua?
Karrigia përballë,
Ajo e kish fajin,
S'përshëndeta dot,
Isha ngatërruar.
Gjaku mbi damarë
Flakë përvëlur,
Dhe zemra e mpirë
Vite e ngujuar,
Trokiste mbi gjoks

Për të fluturuar.
Çudia magjike,
Isha dashuruar.

TI E DI SA SHUMË TË DUA

Të kam dashur shumë dhe të dua
Këtë s'e mohoj aspak
Ti e di si dashuron një grua
Në gjumin e trazuar, më shfaqesh çdo natë.

Më vjen te porta, troket ngadalë
Kur pemët harlisen, kundërmojnë aromë,
Si engjëll i ndrojtur më rri përballë
Dhe mijëra fjalë, të dua të thonë.

Dhe si pa dashje, nis dhe murmuris
Në natën me hënë, strukur në krevat,
Një lumë puthjesh të nxehta të nis
Dhe në qafë të varem si kravatë.

Zgjuar a në gjumë të kërkoj,
Si zanë të ndjek pas krua më krua
Dhe këngë malli për ty këndoj
Të kam dashur shumë dhe të dua...

ATA SY I DUA

Ata sy i dua
Kur lozin me mua,
Dhe kur janë të qeshur,
Dhe kur janë të vrenjtur
Strukur nën vetull,
Prapë ata i dua.

Ata sy i dua
Siç i do një mike
Me zemër besnike
Si relikte antike.

Ata sy i dua
Siç i do një grua
Kur lotojnë si krua
Dhe kërkojnë një emër.

TË KËRCEJ NJË TANGO

Të kërcëj një tango
Në supet e tua,
Lehtë e lehtë mbi taka
Të të them të dua.

Dhe duke kërcyer
Flokët të harlisen,
Dy buzët që digjen
Si pa dashur ngjiten.

Si ngjalë rrotulluar
Gjoks e bel shtrënguar,
Malli përpëlitet
Në këmbë e në duar.

Do të shuaj mall
Të dalë ku të dalë,
Melodi e lehtë
Na fton në parajsë.

Tangoja ime e shtrenjtë
Deri në agim
Pentagrame këngësh
Që nuk kanë mbarim.

MBI QERPIKË TË DASHURUAR

Puthje do derdh pa hesap
Mbi qerpikë të dashuruar,
Lules sime mbi parmak
Diell i paperënduar.

Me puthje, puthjet e mia
Porsi vesa do të lag,
Vetëm ty, jo ç'ke përçark,
Se nga vapa kam merak,
Mos më vyshkesh, e nuk çel prapë.

Lule moj lulja me erë
Je për mua mrekulli,
Kur të fryjë edhe të bjerë
Do të ngroh në krahët e mi.

Më dehu kjo bukuri,
Për mua nuk ka më dy,
Se, edhe krye bukuritë
Nuk ngjasojnë me një të dytë.

Qenien time ke pushtuar
Do të vdes i mrekulluar.

PËR VITIN E RI

Për Vitin e Ri
Të bëhemi dy,
Tek oxhaku i lartë
Të bëhemi bashkë
O shpirt i kristaltë.

Të bëhemi tok
Pa miq e pa shokë,
Se frika më tremb
E dhimbja më dhemb
O dhuratë e shtrenjtë.

Sytë e tu të zinj,
Pjellë dashurie,
Dhe yjet e ndezin,
Dhe në tokë zbresin
Flakë lumturie.

Në gjuhë do të ulem
T'i puth ato duar,
T'i puth ata gjinj
Të nxehtë si thëngjij,
Se jam i malluar.

Ngrohtë mbi sixhade,
Të thurur nga nëna,
Gotat t'i trokasim,
Me ngadalë të flasim,
Se na dëgjon hëna.

Dashuri dhe verë
Dhe buzët bashkuar,
Viti i Ri ylber
Na troket në derë
Dhe na thotë gëzuar.

KUSHËRIRA

Delikate si laboti
Gjitonia ime përballë,
Më dogji më përvëloi
Porsi prushi në mangall.
Trupi i saj si ngjalë deti
Më tronditi porsi tërmeti.

Ç'ke o djalë i përvëluar?
Unë s'jam ujë për të të shuar,
S'jam nga uji i bekuar
Për t'u larë e freskuar.
Kot me mua je ngatërruar
Jemi fis o i uruar.

Kushërirë moj kushërirë
Qasu ti se më vjen mirë.

TË DESHA, S'TË DUA

Të desha, s'të dua
Në jetë ka më keq.
Ka njerëz që s'duhën,
Por bashkë zvarriten në jetë.

Ka njerëz dashnorë
Derisa bëhen pleq,
Specie të rralla,
Që mbeten në përralla.

Të desha, s'të dua,
Në jetë ka dhe më keq,
Ka dhe nga ata
Që dashurinë e blejnë me lekë.

Kështu o njeri, krijesë në këtë botë,
Mos e gënje veten
Me përralla e lugë bosh.
Ke lindur të vuash, apo të jetosh?!

DASHURIA IME E HIJSHME

Paqe dhe vetëm paqe
Dua me ty të kem,
Dashuria ime e hijshme
Vetëm ti kurrë s'më gënjen.

Paqen dhe mirësinë
Në shpirtin tim ke qëndisur,
Zemra e brishtë e një gruaje
Me dashurinë tënde qëndisur.

Dashuria jote me paqe
Seç ma ndez syrin e bukur,
Çdo minutë pa shumë llafë,
S'mbahem dot, bares si flutur.

Unë vërtet kam hijeshinë,
Nazet, linjat, brishtësinë,
Fatin e të qenët grua,
Por kurrë s'kisha gjetur, kurrë,
Paqen, mirësinë në zemër,
Të atij që quhet burrë.

Ballin me yje stolisur
Çdo natë ma ke ulur pranë,
Dhe dashurinë time të braktisur
E shurdhon si sirenë deti,
I shkul rrënjët si tufan
Dhe shpërndan mbi shpirtin tim,
Rreze dielli pa mbarim.

TË KAM NË SY E NË BUZË

Dashuri e malluar
Më mban gjallë, të mbaj në gji,
Kur fle gjumë
E kur jam zgjuar,
Në sy e shkruar më rri.

Rri e shkruar, por pa shkronja,
Se kemi kodet tona,
Kode shpirti përvëlur,
Në kurbet nga ti larguar,
Net me yje, dritë shuar.

Dashuri baladë malli
Të kam në sy e në buzë,
U dogja e m'u dogj xhani
Në vegime mugëtire,
Diku larg, larg nga unë
Të kanë vrarë edhe rri shtrirë.

Të kam në sy e në shpirt,
Se rron ti, dielli bën dritë.
Në krevat me ty mbështillem
Fort shtrëngohem, ledhatohem
Nga puhia që me yjet dërgon.

Dashuri e përvëluar
Perëndesha kaltëroshe,
Më mungojnë buzët e tua
Sa të dua, kur më thoshe,
Të kam në sy e në buzë.

Si rreze margaritar,
Bashkë me dallgën më përcjell
Syrin e zi,
Të ngrohtin mall.
Dashuri pa ty s'ka jetë.

Të desha me hijeshi,
Por i ziu im kurbet
Më ndau përjetë nga ti.
Të këndova, të lotova,
Me mallin e zemrës jetova.

GJETA FUSTANIN E ARTË

Ç'ka fustani që s'ri mirë
Ashtu si dikur i ngrirë?
Apo gjokset janë shtrirë,
Nuk i kanë thithat përpjetë,
Si atëherë që kapnin retë.
Buzë e shkretë, nuk burbuqet,
S'pikon lëng në dritë të hënës
Si dikur në derë të nënës.
Dhe ylberit të kristaltë
Ngjyrat nuk ia shohim qartë.
Vitet rrodhën porsi uji,
Herë me dallgë e herë qetë,
Pa kuptuar u bëmë pleq.
Jo mor jo, bëra shaka,
S'jemi plakur, nuk jam plakë,
Dhe pse gjethet po rrallohen
I them vetes mbahu pak,
Shijo pjesën që ka mbetur,
Se po ike s'kthehesh prapë.
Merr gërshërën, prit fustanin,
Shkurtoje në të bën vapë.

S'të kanë faj gjokset e rëna,
Se ato pikojnë mjaltë,
Lum ai që i ka shijuar
Qoftë dhe vetëm për një natë.
Do të vdesë i lumturuar
Edhe mund të ngjallet prapë,
Që nga varri do thërrasë:
Gjeta fustanin e artë.

KUJTIMI YT

Kujtimi yt, fjollë e bardhë
Pupël mëndafshi, dhimbje dhe mall;
Çdo natë vjen e më puth në ballë,
Më mbështjell me ëmbëlsi,
Aromë trëndafili, syri im, të ledhaton
Me një pikë loti ëndërrimi.

Kujtimi yt, fjollë e bardhë,
Mbi qerpikun tim
Ulet ngadalë,
Dhimbja e tij shpresë trishtimi
Mbetur në rrugën e fantazisë,
Një lule kujtimi...

Kujtimi yt, gatuar me yje e lot valë,
Nga rruga e largët mërmërit ngadalë,
Mbi sy më ulet, mbi ballë
E gjumi i ëmbël më mbyll sytë,
Mes natës së radhës
Ku jam vetë i dytë.